Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*
- d. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

- e. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;
- f. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

Sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” të kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore e realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2016, 2017, 2018) duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet, për të cilën duhet të paraqitet vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore.

2.2.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve (2016, 2017, 2018) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të konfirmuara nga ky autoritet.

2.2.3. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

2.2.4. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitet 2018, 2019 lëshuar prej njësisë së vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetin, referuar adresave kryesore dhe dytësore ku është regjistruar sipas QKB, sipas përcaktimeve në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, *(Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).*

2.3 Për kapacitetin teknik:

Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat si vijon:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik duhet të paraqitet kontrata e lidhur si dhe vërtetimi i lëshuar nga enti publik për realizimin e kontratës.

Ose

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- 2.3.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për “Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi” (lëshuar nga MZHUT ose nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit), ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi

- NP - 1 Punime gërmimi në tokë
NP - 2 Ndërtime civile dhe industriale
NP - 3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale...
NP - 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha...
NP - 5 Punime nëntokësore...
NP - 7 a Ujësjiellës, kanalizime...

Punime speciale ndërtimi

- NS - 1 Punime për prishjen e ndërtimeve
NS - 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to...
NS - 8 b Struktura metalike
NS - 9 Punime strukturore speciale
NS - 18 Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

- 2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë)
- ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit Mjedisor)
- OHSAS 18001:2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose ISO 45001:2018
- PAS 99:2012 (Sistemi i Integruar i menaxhimit)
- ISO 39001:2012 (Për sigurinë në trafikun rrugor)

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatat e mësipërme, sipas natyrës së shërbimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit

- 2.3.4.** Për efekt të kryerjes së shërbimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 10 (dhjetë) punonjës të siguruar për periudhën Dhjetor 2019 - Maj 2020, dokumentuar me vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimore. Gjithashtu ofertuesi duhet të paraqesë listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohen nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj të periudhës së mësipërme.
- 2.3.5.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë, drejtues teknik të kualifikuar si më poshtë:
Drejtues Teknik Inxhinier Ndërtimi, 1 (një),
Drejtues Teknik Inxhinier Hidroteknik, 1 (një),
Drejtues Teknik Inxhinier Mekanik/Elektromekanik, 1 (një),
Drejtues Teknik Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder, 1 (një),
Drejtues Teknik Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik, 1 (një),
Për stafin e drejtuesve teknik duhet të paraqitet kontrata individuale e punës (e vlefshme) e lidhur para noterit, Diplomë, CV, Licencë Profesionale personale për “Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi”.
- 2.3.6.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një analizë të çmimit mbi tarifën/at profesionale të ofruara, duke specifikuar saktë të gjithë elementet që ka marrë parasysh në llogaritjen e çmimit, si dhe duke plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Në zbatim të rekomandimit të APP me nr.5585 prot, datë 25.07.2017 “*Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe rekomandimit të APP me nr.6559 prot, datë 27.06.2018, për llogaritjen e çmimit të ofertës së tyre, Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë parasysh sa më poshtë:*

Vlera e ofruar duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Vlera limit prej **4’269’042.24** (katërmilion e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyzetë e dy pikë njëzetë e katër) **lekë pa TVSH**, është vlera maksimale e llogaritur me vlerat e tarifave maksimale për grupin përkatës dhe objekti për të cilin kërkohet supervizioni/mbikëqyrja e punimeve, bën pjesë në grupin e tretë tarifor.

Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen.

Orientim për Operatorët Ekonomikë lidhur me objektin për të cilin kërkohet supervizioni:

Të dhënat e objektit për të cilin do të bëhet supervizioni/mbikqyrja, janë si më poshtë:

Vendodhja: qyteti Ballsh dhe fshati Lavdan, Bashkia Mallakastër

Objekti: “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”

Dokumentat Standarde të Tenderit

Fondi limit i punimeve të zbatimit të objektit: **421,842,119** (katërqind e njëzetë e njëmilion e tetëqind e dyzetë e dymijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH**

Afati i punimeve të zbatimit: 24 (njëzetë e katër) muaj (Shënim për mbikqyrjen: Pavarësisht përcaktimit të afatit 24 muaj, afati i kësaj kontrate do të shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së zbatimit të punimeve (duke filluar nga nënshkrimi i kontratës deri në përfundimin e plotë të punimeve të zbatimit të objektit “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”), përfshirë edhe shtytjet e mundshme të afatit, që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës.)

Procedura e objektit për të cilin do të bëhet mbikqyrja është shpallur në sistemin e prokurimit elektronik, në adresën www.app.gov.al, me numër reference REF-58017-05-13-2020.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj: Bashkëlidhur në skedarët e Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: sipas Termave të Referencës.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Mbikëqyresi i punimeve duhet të përmbushë të gjitha detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimit të KM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar me Udhëzimin e KM nr.4, datë 17.05.2001, Udhëzimin e KM nr.7, datë 21.11.2001, Udhëzimin e KM nr.1, datë 22.02.2005 dhe Udhëzimin nr.1 të KM datë 16.06.2011 dhe të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		

Dokumentat Standarde të Tenderit

02		
03		
...		

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

“Supervizion punimesh për objektin: “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”

Afatet e ekzekutimit:

24 muaj

(Shënim për mbikqyrjen: Pavarësisht përcaktimit të afatit 24 mujor, afati i kësaj kontrate do të shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së zbatimit të punimeve (duke filluar nga nënshkrimi i kontratës deri në përfundimin e plotë të punimeve të zbatimit të objektit “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”), përfshirë edhe shtytjet e mundshme të afatit, që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës.)

Shtojca 11

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

“SUPERVIZION PUNIMESH PËR OBJEKTIN: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT SHPËRNDARËS TË QYTETIT BALLSH”

I – INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Objekti: “Supervizion punimesh për objektin “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, bazuar në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, bën pjesë në objektet që i përkasin kategorisë “Vepra Inxhinierike”, grupi tarifor III.

Afati për realizimin e shërbimit të supervizionit/mbikëqyrjes do të shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së zbatimit të punimeve nga shoqëria sipërmarrëse, përfshirë edhe shtytjet e mundshme të afatit, që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës, si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë.

Të dhënat e objektit për të cilin do të bëhet supervizioni/mbikëqyrja e punimeve:

Objekti: “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”

Vlera e investimit: 421,842,119 (katërqind e njëzetë e njëmilion e tetëqind e dyzetë e dymijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

II – OBJEKTIVI KRYESOR

Supervizori/Mbikëqyrësi i punimeve të zbatimit të objektit, ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjekë mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve, duke përfshirë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve të këtij objekti (afatin sipas grafikut të punimeve) dhe anën ekonomike të objektit (vlefata e kontratës së zbatimit punimeve).

III – DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E SUPERVIZORIT/MBIKËQYRËSIT

Në realizimin e objektivave për shërbimin e mbikëqyrjes së objektit: “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, Mbikëqyrësi/Supervizori i punimeve, menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të mbikëqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Bashkisë Mallakastër dhe të kryejë të gjitha detyrimet që i janë besuar atij sipas kontratës së nënshkruar dhe sipas, Ligjit Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet përkatëse, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet përkatëse, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe çdo akti tjetër ligjor apo nënligjor që parashikon këtë veprimtari.
- Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standarteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- Të paraqesë pranë Bashkisë Mallakastër stafin e tij mbikëqyrës, siç është përcaktuar në kërkesat e stafit kryesor.
- Në bazë të volumit të punimeve dhe vlefës së kontratës drejtuesi i punimeve duhet të jetë rezident në objekt dhe stafi tjetër mbikëqyrës mund të jetë rezident çdo ditë në objekt ose me kohë të pjesëshme.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Mbikëqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Bashkia Mallakastër, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të ndryshme që mund të lindin gjatë zbatimit.
- Mbikëqyrësi, në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse lokale ose qëndrore në juridiksionin e të cilit ndodhet zona e ndërtimit ku kryhen punimet e këtij objekti dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mbikëqyrësi në fillimin e punimeve së bashku me zbatuesin e punimeve duhet të bëjë një inspektim të gjëndjes ekzistuese duke bërë inventarin e plotë të të gjitha aseteve që do të hiqen dhe do të magazinohen, si dhe të tjerat që do të prishen.

Mbikëqyrësi/Supervizori ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, autorizimeve dhe të lejeve që sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- Të njihet me hollësi me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundëshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit, sipas përmasave, të dhënave dhe formatit të parashikuar nga aktet në fuqi.
- Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit, duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese, të sigurisë, shiritave, fenerëve etj.
- Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë Bashkisë Mallakastër të gjithë dokumentacionin, si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:
 - Stafi i sipërmarrësit;
 - Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit;
 - Laboratori i liçensuar që do të kryej testet e materialeve;
 - Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së zbatimit;
 - Të kontrollojë zbatimin e projektit, duke u bazuar në projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka, dhe ti propozojë Bashkisë Mallakastër, zgjidhjet konkrete;
 - Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacionit që duhet të mbahet gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave;
 - Të kërkojë dhe të zbatojë në mënyrë korrekte plan-organizimin e punimeve të objektit;
 - Të kërkojë dhe të zbatojë lejen (autorizimin, pëlqimin) mjedisore të miratuara nga organi kompetent;
 - Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit, kuotat e thellësisë së kanaleve dhe kuotat e vendosjes së veprave të artit;
 - Të respektojë dokumentacionin përkatës kur objekti ndërtohet në zonat turistike,

Dokumentat Standarde të Tenderit

- arkeologjike apo të trashëgimisë kulturore;
- Të kontrollojë bazamentin e objektit dhe të japë miratimin e tij për vazhdim të punimeve;
- Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes dhe cilësinë e tij;
- Për çdo punim të dukshëm ose të padukshëm në të gjitha fazat e ndërtimit të bëjë fotografimin ose regjistrimin e tij dhe të mbaj proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit, (sipas formatit të miratuar);
- Në fund të çdo dite pune, të kontrollojë ditarin e punimeve dhe ta firmos atë (sipas formatit të miratuar);
- Të kontrollojë situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve dhe miratojë ato (sipas formatit të miratuar);
- Të kontrollojë librezën e masave ku pasqyrohen volumet e vëllimet metrike, gradualisht me zhvillimet e tyre dhe ta miratojë atë (sipas formatit të miratuar);
- Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të japë miratimin për vendosjen e tyre në objekt;
- Të njoftojë sipërmarrësin për difektet e vëna re dhe kohën e korrigjimit të tyre; Punimet me difekte nuk pranohen dhe nuk financohen deri në korrigjimin e tyre;
- Gjatë zbatimit të projektit i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit sa herë që e sheh të nevojshme dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij, lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë nga mbikëqyrësi i punimeve;
- Për çdo rast që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projekt-Preventivin e parashikuar, mbikëqyrësi i punimeve duhet të paraqesë pranë Bashkisë Mallakastër, një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi i miratuar edhe nga projektuesi dhe më pas ky ndryshim do të zbatohet në objekt vetëm pas miratimit nga Bashkia Mallakastër;
- Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë Bashkisë Mallakastër raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve, pagesave të kryera, realizimin e punimeve në vleftë dhe % , afatin kohor e realizimin e financimit;
- Të nënshkruajë aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve për faza të ndryshme;
- Të marrë pjesë, sa herë që kërkohet nga Bashkia Mallakastër, për inspektimin e objektit gjatë periudhës së garancisë dhe të nënshkruajë aktin, lidhur me përfundimet e inspektimit;
- Të marrë pjesë në kontrollin e veprës pas përfundimit të periudhës së garancisë dhe të nënshkruajë përfundimet e dala nga ky kontroll.

Mbikëqyrësi/Supervizori mban përgjegjësi të plotë:

Mbikëqyrësi i punimeve është përgjegjësi kryesor për zbatimin e objektit.

Me fillimin e punimeve mbikëqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e objektit si më poshtë vijon:

1. Vendimin/Lejen/Autorizimin për miratimin e objektit;
2. Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori sëbashku me specifikimet teknike;

Dokumentat Standarde të Tenderit

3. Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet;
4. Dokumentacionin për realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike;
5. Saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit;
6. Për realizimin me korrektësi të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe Autoritetit Kontraktor/Bashkisë Mallakastër, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit;
7. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikëqyrësit. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij;
8. Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Autoritetin Kontraktor, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.
9. Në rastin kur gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërrim të Mbikëqyrësit, të mbahet procesverbali i dorëzimit të punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri.
10. Autoriteti Kontraktor kontrollon praninë e mbikëqyrësit të punimeve në objekt dhe në rast konstatimi të mungesës së tij, nxjerr vendimin për pezullimin e punimeve deri në emërimin dhe praninë e tij në objekt;

Mbikëqyrësi/Supervizori ka të drejtë:

- Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë në punë;
- Të mos pranojë drejtues teknik , manovrator, punëtor, n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar;
- Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun;
- Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij;
- Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve;
- Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt dhe cilësore;
- Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike;
- Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi, këto duhet të dokumentohen me procesverbalet e analizave të provave sëbashku me aktin teknik ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit;
- Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar

Dokumentat Standarde të Tenderit

- për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
- Të kërkojë kryerjen e provave me ngarkesë ose pa ngarkesë sipas Standarteve Shqiptare të miratuara nga Drejtoria Përgjithshme e Standartizimeve, K.T.P apo K.T.Z në fuqi për tubacionet e vendosura në objekt;
 - Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime të rënda, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
 - Mbikëqyrësi i punimeve urdhëron sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt-zbatimin ose në Specifikimet Teknike;
 - Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë perkohësisht punimet për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e Bashkisë për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas fajit, mbikëqyrësi së bashku me Bashkinë dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit të punimeve dhe të ndryshimit të shpenzimeve.
 - Mbikëqyrësi duhet të firmosë gjithë dokumentacionin që ka miratuar, ai mban përgjegjësi ligjore së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit të miratuar nga mbikëqyrësi i dorëzohet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit të objektit.
 - Mbikëqyrësi merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës si dhe firmos procesverbalin e kolaudimit;
 - Mbikëqyrësi kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Bashkisë Mallakastër për gjëndjen e tij. Në rast se Bashkia ka vërejtje e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

Në përfundim të punimeve mbikëqyrësi/supervizori:

- Mbikëqyrësi me kërkesë të sipërmarrësit vërteton në procesverbal datën e përfundimit të punimeve sipas projektit, kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara në kushtet e kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej tij dokumentacionin përkatës.
- Duke u mbështetur në Ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet përkatëse, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet përkatëse dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, dorëzon pranë Autoritetit Kontraktor/Bashkisë Mallakastër të gjithë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi, për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin saktësinë dhe vërtetësinë e tij. I gjithë ky dokumentacion duhet të ketë miratimin e mbikëqyrësit të punimeve.
- Dokumentacioni i mësipërm përgatitet e dorëzohet në 3 (tre) kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë kolaudatorit ose grupit të kolaudimit brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve në objekt.
- Dokumentacioni që dorëzohet tek kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të jetë origjinal.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos procesverbalin e kolaudimit.
- Mbas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe dokumentacionin tjetër përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për likujdim Autoritetit Kontraktor.
- Sa herë që kërkohet nga Autoriteti kontraktor, Mbikëqyrësi merr pjesë në inspektimin e objektit gjatë periudhës së garancisë dhe duhet të nënshkruajë aktin, lidhur me përfundimet e inspektimit;
- Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kontrollin e veprës mbas përfundimit të periudhës së garancisë dhe nënshkruan përfundimet e dala nga ky kontroll.

IV - KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES/SUPERVIZIONIT.

Kohëzgjatja e shërbimit të mbikëqyrjes/supervizionit do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve deri në përfundimin e objektit përfshirë kolaudimin, si dhe inspektimet gjatë periudhës 2 vjeçare të garancisë së difekteve kur kërkohet nga Bashkia Mallakastër.

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Dokumentat Standarde të Tenderit

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Dokumentat Standarde të Tenderit

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[*Data*]

Për: [*Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues*]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj*]

Dokumentat Standarde të Tenderit

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Shërbimet –Kërkesë për propozim**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

